

6.

V E N D I M
Nr. 91, datë 30.1.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË PYJORE DHE
POLICISË SË NDËRTIMIT**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, mbështetur në fondet e caktuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 1998, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.185, datë 16.4.1993 "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 5 800 në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtori, kryetar dege) bëhet 14 900 lekë në muaj. Kompensimi për vete dhe për personat në ngarkim që ka përfituar çdo ushtarak, bashkohet me pagën bazë mujore.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 238, datë 16.4.1996 "Për organizimin dhe strukturën e policisë së ndërtimit", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 5800 në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie, kryetar dege) bëhet 14 900 lekë në muaj. Kompensimi për vete dhe për personat në ngarkim që ka përfituar çdo i punësuar, është bashkuar me pagën bazë mujore.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit për vitin 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shkurt 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano